

Mediat dhe trafikimi i qenieve njerëzore

UDHËZUES



Financuar
nga Bashkimi Evropian
dhe Këshilli i Evropës



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet
nga Këshilli i Evropës



Ky Udhëzues është version i përshtatur dhe i përkthyer nga publikimi origjinal **“Media and Trafficking in Human Beings Guidelines”** i përpiluar në vitin 2017 në kuadër të projektit **“Lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe krimin të organizuar – faza 2”**. Projekti u financua nga Komisioni Evropian, ndërsa u implementua nga Qendra Ndërkombëtare për Zhvillimin e Politikave të Migracionit (ICMPD) në bashkëpunim me Expertise France dhe FIAPP.

Me lejen e ICMPD, Udhëzuesi u përshtat në kuadër të projektit **“Parandalimi dhe Lufta Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore në Maqedoninë e Veriut”**, pjesë e Instrumentit Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë – faza e dytë, i implementuar nga Këshilli i Evropës.

Titulli origjinal: Ethical Journalism Network (2017), **Media and Trafficking in Human Beings Guidelines**, ICMPD.

Autor: Ejdan Uajt, Rrjeti i Gazetarisë Etike

Ekipi i ICMPD: Madis Vainomaa, Ivanka Georgieva, Edgar Federsoni dos Santos, Uiliam Hadlston



Përktheu në gjuhën shqipe:

Blerina Starova Zllatku



© 2021 Këshilli i Evropës.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Të drejtat e shfrytëzimit i ka Bashkimi Evropian në kushte të caktuara. Asnjë pjesë e publikimit nuk guxon të përkthehet, riprodhohet ose transmetohet, në çfarëdo qoftë forme ose me çfarëdo qoftë mjeti, elektronik (CD-rom, Internet, etj.) ose mekanik, duke përfshirë fotokopjimin, regjistrimin ose ndonjë sistem tjetër të ruajtjes ose të shkarkimit të të dhënave, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Direktoratit për Komunikime (F-67075 Strasburg Cedeks ose publishing@coe.int).

Ky publikim u hartua mbështetjen financiare të një programi të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Përmbajtja e këtij publikimi në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pikëpamjet zyrtare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës.



PËRMBAJTJA

1.	HYRJE	4
2.	STRATEGJITË E REDAKSIVE	9
3.	PRAKTIKA TË MIRA	11
4.	UDHËZIME PËR FOTOGAZETARI	21
5.	PRAKTIKA TË GABUARA	23
6.	LINQE DHE KONTAKTE	27
	KONTAKTE TË INSTITUCIONEVE DHE ORGANIZATAVE RELEVANTE NË MAQEDONINË E VERIUT	27
	INSTITUCIONE DHE ORGANIZATA RELEVANTE NDËRKOMBËTARE	30
	DISA INICIATIVA DHE RESURSE KRYESORE POLITIKE TË AGJENCIVE NDËRKOMBËTARE	32
	LINQE TË DOBISHME DHE SHEMBUJ PËR RAPORTIM TË MIRË	34
	DISA NGA UDHËZIMET EKZISTUESE PËR RAPORTIMIN MAQEDONAS	35



Storja për trafikimin e qenieve njerëzore është njëra nga detyrat më të vështira, më komplekse dhe më sfiduese etike për gazetarët dhe redaktorët.

1. Hyrje

Trafikimi i qenieve njerëzore është storje me numra marramendës. Njerëzit të cilët janë viktimat të trafikimit të qenieve njerëzore vijnë nga kategoritë më vulnerable. Sipas përlogaritjeve në vija të trasha, 40 milionë njerëz jetojnë në eksploatim; 150 milionë fëmijë janë të detyruar të punojnë, ndërsa numri i punëtorëve migrantë është rreth 150 milionë. Me miliona prej këtyre njerëzve (askush nuk e din numrin e saktë) njëherësh bëhen edhe viktimat të trafikimit të qenieve njerëzore. Që të shpjegohet storja e tyre, para së gjithash, nevojitet kujdes dhe ndjeshmëri, meqë vokabulari, mënyra e narracionit të storjes dhe konteksti në të cilin mediat dhe gazetarët raportojnë mund t'i shkaktojnë dëm, të nxisin urrejtje, të stimulojnë stereotipa. Nga ana tjetër, mënyra e narracionit të storjes mund të krijojë mosmarrëveshje, ta tërheq vëmendjen e publikut nga shkaktuesit, si dhe ta pamundësojë debatin e nevojshëm publik për atë se si t'i përgjigjemi këtij fenomeni.

Ky **Udhëzues** synon t'u ndihmojë punonjësve të medias, para së gjithash redaktorëve dhe reporterëve që më mirë ta kuptojnë fenomenin e trafikimit të qenieve njerëzore ndërsa narracioni i storjeve të formulohet në atë mënyrë që do t'i shmangin rreziqet të cilat qëndrojnë pezull mbi mjedisin agresiv dhe konkurrent të medias.

Gara për publikimin e storjes, bota konfuzë dhe e pasigurt e rrjeteve sociale, si dhe nd-

ikimi gjithnjë në rritje i propagandës dhe politikës kontribuojnë që gazetaria gjithnjë e më shumë të fundoset në botën e titujve sensacional dhe frazave mbresëlënëse.

Trafikimi i qenieve njerëzore është një problem kompleks shoqëror për të cilin nevojitet një gazetar emblematic, mirë e informuar dhe para së gjithash, një gazetar sensitiv e cila do ta prezantojë kontekstin, do t'u jap fjalë viktimave dhe do të ndihmojë në gjetjen e zgjidhjes.

Mediat dhe gazetaria duhet të kenë rol pozitiv në ndërgjegjësimin e përgjithshëm për atë se trafikimi i qenieve njerëzore mund të çrrënjoset. Liderët politikë dhe opinioni i përgjithshëm duhet ta lexojnë, dëgjojnë dhe shohin storjen e plotë. Ky është hapi i parë esencial për përfitimim e vullnetit politik të nevojshëm për tejkalimin e motiveve themelore të trafikimit të qenieve njerëzore.

Këshillat dhe propozimet në këto faqe mund t'u ndihmojnë gazetarëve të reflektojnë në lidhje me raportimet e tyre për trafikimin e qenieve njerëzore, t'i marrin parasysht çështjet juridike që kanë të bëjnë me këtë fenomen si edhe të drejtat e njeriut, ta detektojnë se si trajtohen viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, privatësinë dhe mirëqenien e tyre dhe si ta artikulojnë narracionin e storjes në mënyrë humane dhe të kuptueshme.

Njohja me bazat

Gazetaria autentike nga raportuesit dhe redaktorët kërkon që të jenë mirë të informuar dhe ta kuptojnë atë që e flasin. Termat që i përdorim për raportimin e trafikimit të qenieve njerëzore shpeshherë kanë përkufizime të qarta juridike. Gazetarët duhet t'i përdorin me kujdes dhe me saktësi.

Trafikimi i qenieve njerëzore nënkupton eksploatim dhe shkelje të të drejtave të njeriut. Trafikantët me qenie njerëzore njerëzit i perceptojnë si individë. Zakonisht lidhen me rrjete kriminale të cilat e organizojnë trafikimin e qenieve njerëzore me qëllim të punës me detyrim, punës me detyrim në kushte të shtëpisë, eksploatimit seksual, skllavërisë, transplantimit të organeve. Njerëzit janë vulnerabil sa i përket trafikimit të qenieve njerëzore nëse nuk posedojnë leje udhëtimi nga vendi i tyre i origjinës ose nëse nuk janë paraqitur që të jetojnë dhe punojnë në vendin e destinacionit.

Trafikimi i qenieve njerëzore:

- është vepër penale;
- bëhet kundër vullnetit të personit të trafikuar ose pa lejen e tij;
- është pjesë e marrëdhënies afatgjatë, të eksploatimit;
- nënkupton profit nga eksploatimi;
- mund të jetë i brendshëm ose ndërkombëtar.

Instrumentet kryesorë ndërkombëtar dhe juridikë që kanë të bëjnë me trafikimin e qenieve njerëzore janë: Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Krimin të Organizuar Transnacional (2000) dhe protokollet e saj, dhe veçanërisht Protokollin për Parandalimin, Luftimin dhe Dënimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore, veçanërisht trafikimit me gra dhe fëmijë (i njohur edhe si Protokollin i Palermos); Konventa e Këshillit të Evropës për Veprim Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (2005); si dhe Direktiva 2011/36 e BE-së për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Mbrojtjen e Viktimave (2011).

Kontrabandimi i migrantëve është marrëdhënie komerciale që nënkupton ofrim të ndihmës njerëzve që të udhëtojnë në mënyrë të parregullt dhe t'i shmangin procedurat zyrtare me të cilat rregullohet qarkullimi i njerëzve nga një vend në një vend tjetër. Bëhet fjalë për vepër penale kundër ligjeve nacionale dhe jo kundër personit në fjalë. Në shumë raste, kontrabandistët mund t'i shkelin edhe të drejtat e njeriut të migrantëve, megjithatë roli i tyre kryesorë ka të bëjë me atë që ata i ofrojnë shërbimet të cilat migrantët ose refugjatët i kërkojnë, kur të njëjtat nuk janë të aksesshme përmes migrimit të rregullt.

Sipas Kombeve të Bashkuara, kontrabanda: “është sigurimi, i dobisë së drejtpërdrejtë ose të tërthortë financiare ose dobisë tjetër materiale, nga hyrja ilegale e personit në shtetin-palën në të cilin personi nuk është shtetas ose banor rezident”.¹

¹ Protokollin kundër kontrabandimit të migrantëve përmes tokës, detit dhe ajrit, i cili e plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara Kundër Krimin të Organizuar (2000), Neni 3a.

Kontrabandimi i migrantëve:

- Është vepër penale kundër shtetit;
- Bëhet me pëlqimin e personit i cili është objekt i kontrabandimit;
- Shpeshherë është marrëdhënie e njehershme komerciale;
- Nënkupton pagesë për kontrabandistin për shërbimin e ofruar;
- Nënkupton kalim të kufirit shtetëror.

Mekanizmi Nacional i Referimit (MNR) është një koncept ose kuadër në të cilin institucionet dhe organizatat qytetare në një shtet bashkëpunojnë me qëllim të identifikimit dhe ofrimit të ndihmës për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore.

Mekanizmat e këtillë ekzistojnë në formën e zyrave nacionale, ndonjëherë edhe si praktika de fakto të bashkëpunimit midis institucioneve kompetente shtetërore dhe protagonistëve nga shoqëria civile. Koncepti i MNR fillimisht u zhvillua nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim e Evropës-OSBE, ndërsa Konventa e Këshillit të Evropës për Veprim Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore përmban kornizë për bashkëpunim midis institucioneve dhe sektorit joqeveritar për identifikimin dhe ndihmën e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore. Në Maqedoninë e Veriut MNR funksionon në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale dhe ka për qëllim të siguroj identifikim, ndihmë dhe mbrojtje të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore.

Komisioni Nacional për Luftë Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Migracionit Ilegal në Maqedoninë e Veriut është autoritet ndërsektorial i cili ka për qëllim ta koordinoj punën e të gjitha institucioneve të përfshira në procesin e mbrojtjes, parandalimit dhe hetimit në lidhje me rastet e trafikimit të qenieve njerëzore. Me Komisionin udhëheq **Koordinatori Nacional**. Në kuadër të Komisionit funksionon **Sekretariati**, organ i cili është përgjegjës për pranimin dhe implementimin e vendimeve të Komisionit Nacional i cili përfshin përfaqësues të institucioneve shtetërore, organizatave joqeveritare, organizatave ndërkombëtare dhe autoriteteve qeveritare. Në kuadër të Komisionit është edhe **Nëngrupi për fëmijë-viktima të trafikimit të qenieve njerëzore**, i cili e ka për qëllim mbrojtjen dhe parandalimin e fëmijëve viktima të trafikimit të qenieve njerëzore.

Raportuesi Nacional është autoritet i pavarur ose qeveritar, roli primar i të cilit është mbikëqyrja e aktiviteteve të përgjithshme në lidhje me luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Autoritetet e këtilla janë përgjegjës edhe për grumbullimin dhe analizën e të dhënave në kontekst të mbrojtjes, parandalimit dhe ndjekjes penale të kryerësve, si dhe ndjekjen dhe monitorimin e implementimit të planeve të veprimit për luftë kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Në Maqedoninë e Veriut, nga viti 2019 Raportuesi vepron si organ i pavarur në kuadër të Avokatit të Popullit, me mandat që të ushtroj mbikëqyrje dhe analizë mbi gjendjen momentale me trafikimin e qenieve njerëzore dhe mbi tendencat e migracionit të parregullt, si dhe të publikoj raporte vjetore.

Mekanizmi Transnacional i Referimit është marrëveshje bashkëpunimi për ndihmë

gjithëpërfshirëse ndërkufitare dhe/ose për transferimin e personave të identifikuar ose të personave potencialisht të trafikuar. I sublimon të gjitha fazat e procesit të referimit, nga skringu fillestar, përmes identifikimit dhe ndihmës formale, deri në kthimin e ndihmuar vullnetar, inkluzionin social, procedura civile dhe penale. Bazohet në bashkëpunimin ndërmjet institucioneve qeveritare, agjencive ndërqeveritare dhe organizatave joqeveritare të vendeve të origjinës, transitit dhe destinacionit, në përphtje me obligimet për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Migrantët pa dokumente ose migrantët e parregullt shpeshherë gabimisht, emërtohen si “ilegal”. Është e qartë se bëhet fjalë për paragjykitime kur përdoret ky term. Megjithatë, disa migrime janë jolegale, kur njerëzit zgjedhin ta shkelin ligjin në mënyrë që do të migrojnë ilegalisht. Parapëlqehet të përdoret termi migrantë **“të parregullt” ose “të pa dokumentuar”**. Megjithatë, me këtë nuk guxon të mjegullohet dënimi i kontrabandimit të njerëzve dhe trafikimi me qenie njerëzore. Nuk janë të cenueshëm të gjithë migrantët e parregullt ndaj trafikimit me qenie njerëzore, megjithatë, janë në rrezik nga eksploatimi dhe abuzimi i të drejtave të njeriut, veçanërisht kur i shfrytëzojnë shërbimet e kontrabandistëve. Statusi i imigrantit të parregullt në vendin e destinacionit mund të çoj në eksploatim të personave të frikësuar nga organizatorët e punës me detyrim dhe skllavërisë.

Sklavëria ose skllavëria bashkëkohore është një term i përgjithshëm dhe gjithëpërfshirës i cili ngërthen forma të ndryshme të detyrimit dhe eksploatimit, me ç’rast personi nuk mund të refuzojë ose të largohet për shkak të kërcënimeve, dhunës, mashtrimit dhe/ose keqpërdorimit të fuqisë. Skllavëria në mënyrë eksplicite ndalohet me të drejtën ndërkombëtare. Përfshinë edhe çështje të tjera, siç është lidhja e detyrueshme e martesës, puna me detyrim ose trafikimi i qenieve njerëzore. Me qëllim të matjes së shkallës së skllavërisë, organizatat ndërkombëtare fokusohen në numrin e njerëzve të cilët punojnë punë me detyrim ose jetojnë në martesë me detyrim.

Trafikimi i qenieve njerëzore me qëllim të eksploatimit seksual është kur personi i rritur futet në akt komercial seksual, siç është prostitucioni, si rezultat i forcës, mashtrimit, kërcënimit ose shtrëngimit.

Trafikimi me fëmijë me qëllim të eksploatimit seksual dallon nga trafikimi me personat e rritur me atë që për fëmijët asnjëherë nuk mund të thuhet se kanë dhënë pëlqim për shitje për akt seksual. Termi prostitucion i fëmijëve është shpesh i përdorur, por në mënyrë të gabueshme e përshkruan eksploatimin komercial seksual të fëmijëve. Përfshinë, prostitucioni i fëmijëve është formë e krimit të organizuar të cilën e menaxhojnë rrjete kriminale, ndërsa shpeshherë e mbështesin edhe trafikantët me qenie njerëzore.

Lidhja e martesës me detyrim ndodh kur gruaja ose vajza, ndonjëherë burri ose djali, detyrohen të lidhin martesë kundër vullnetit të tyre. Vajzën ndoshta e ka shitur familja e saj, e kanë dhënë që ta shlyejnë borxhin familjar, ose e kanë dhënë që ta kthejnë “nderin” e vajzës.

Varësia e skllavërisë shtëpiake ndodh kur personat të cilët kryejnë punë shtëpiake dhe ndihmojnë në shtëpi nuk u lejohet të largohen nga familja ku punojnë; zakonisht nuk

kanë pagë ose pagën e kanë shumë të ulët, ndërsa shpeshherë edhe i keqpërdorin.

Puna me detyrim definohet si situatë kur njerëzit detyrohen të punojnë përmes përdorimit të dhunës ose frikësimit, ose përmes mënyrave më suptile, siç është borxhi i krijuar i madh, marrja e dokumenteve personale, ose përmes kërcënimit se do t'u dorëzohen organeve të migracionit. Shumica e rasteve të skllavërisë ose trafikimit të qenieve njerëzore nënkuptojnë edhe punë me detyrim.

Puna me obligim nënkupton që personi të pranoj borxh të cilin pritët që ta shlyej përmes punës, por ky borxh në të vërtetë është një borxh i cili vetëm rritet dhe me kalimin e kohës nuk mund të shlyhet.

Skllavëria e dakordësuar ndodh kur personi do të mashtrohet dhe do të vihet në skllavëri përmes përdorimit të marrëveshjeve të rrejshme për punë. Njerëzit mashtrohen përmes premtimeve për punësim, por sapo të arrijnë në vendin e punës, i detyrojnë të punojnë pa para ndërsa ata nuk mund të largohen nga situata e këtillë.

Puna e fëmijëve definohet me të drejtën ndërkombëtare. Ka të bëjë me punën që e kryejnë fëmijët, dhe përmes punës eksploatohen ekonomikisht, ose përmes punës e cila mund të jetë e rrezikshme, pengohet arsimi i tyre ose është e dëmshme për zhvillimin fizik, mendor, shpirtëror, moral ose social të fëmijëve. Mbani mend, si punë e fëmijëve nuk konsiderohet çdo punë të cilën e kryejnë fëmijët, por nëse kjo punë e rrezikon mirëqenien e tyre, i privon nga fëmijëria e shëndetshme ose ua konteston të drejtën që të shkojnë në shkollë, atëherë thuaja se sigurisht bëhet fjalë për abuzimin e të drejtave të tyre.

Format më të këqija të punës së fëmijëve është term ndërkombëtar për përshkrimin e situatave në të cilat fëmijët kryejnë punë me detyrim, përfshihen në prostitucion ose pornografi, ose marrin pjesë në aktivitete të kundërligjshme. Instrumentet kryesorë ndërkombëtarë dhe juridikë të cilët kanë të bëjnë me punën e fëmijëve janë Konventat e Organizatës Ndërkombëtare të Punës që kanë të bëjnë me moshën më të vogël të punës dhe me format më të këqija të punës së fëmijëve ², si dhe Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve ³ Veç tjerash, trafikimi me fëmijë në mënyrë të veçantë është përfshirë me Protokollin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore të Kombeve të Bashkuara dhe vlen për të gjithë personat deri në moshën 18 vjeçare. ⁴

² Organizata Ndërkombëtare e Punës (ONP), Konventa nr. 138 e cila ka të bëjë me moshën minimale të punës. (1973) dhe Konventa nr. 182 e cila ka të bëjë me format më të këqija të punës së fëmijëve. Shih më shumë në: <https://www.ilo.org/ippec/facts/IL0conventionsonchildlabour/lang--en/index.htm>

³ Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara (1989). Konventa për të Drejtat e Fëmijëve. United Nations, Treaty Series, vol. 1577, p. 3, e aksesshme në: <https://www.refworld.org/docid/3ae6b38f0.html>

⁴ Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara (2000). Protokollin për parandalimin, luftimin dhe dënimin e trafikimit të qenieve njerëzore, veçanërisht të grave dhe fëmijëve, i cili e plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara Kundër Krimit të organizuar transnacional. Neni 3. <https://www.refworld.org/docid/4720706c0.html>

Mediat duhet të informojnë për kontekstin e storjeve të trafikimit të qenieve njerëzore dhe t'i respektojnë standardet profesionale.

2.

Strategjitë e redaksive

Redaksitë duhet të kujdesen që gazetarët:



T'i kuptojnë shkaqet/motivet e shfaqjes së trafikimit të qenieve njerëzore. Problemet e ndryshme sociale, ekonomike dhe politike shkaktojnë njerëzit të bëhen fragjil ndaj trafikimit të qenieve njerëzore dhe eksploatimit. Këtu bëjnë pjesë rregullat e migracionit, varfërisë, diskriminimit racor dhe gjinor, nivelit të korrupsionit të shtetit, si dhe ligjet joadekuate dhe implementimi i dobët i ligjeve. Gazetarët duhet të jenë të vetëdijshëm për këto aspekte.

T'i hetojnë politikat publike të cilat njerëzve do t'u sigurojnë qasje deri te të drejtat e tyre, si për shembull aranzhmane të sigurt për udhëtim konform të drejtës dhe standardeve ndërkombëtare, si dhe liri ta kërkojnë të drejtën e banimit ose qasje në tregun e punës në vendet e destinacionit;

T'i mbikëqyrin situatat në shtetet e tjera në mënyrë që të hetojnë nëse janë vendosur sisteme për identifikimin e trafikimit të qenieve njerëzore, si dhe a ekzistojnë dispozita ligjore për sigurimin e mbrojtjes dhe rehabilitimit përkatës të fëmijëve dhe personave të rritur të trafikuar në nivel nacional.;

Të krijojnë relacione të mira pune me grupet që punojnë në luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe abuzimit të të drejtave të fëmijëve.

T'i ndërtojnë kapacitetet e tyre. Redaksitë duhet t'u sigurojnë gazetarëve kohë të mjaftueshme që t'i investigojnë informacionet që kanë të bëjnë me trafikimin e qenieve njerëzore, si dhe të investojnë në gazetarinë investigative. Është me rëndësi që redaksitë

të mbajnë brifingje për çështjet lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore, të vendosin kontakte me publikun përmes lidhjeve telefonike dhe mënyrave të tjera të komunikimit, duke e përfshirë këtu edhe pranimin e ankesave që kanë të bëjnë me storjet e publikuara për trafikimin e qenieve njerëzore dhe migracionin;

Të kontribuojnë në përmirësimin e grumbullimit të të dhënave dhe shkëmbimit të informacioneve lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore, punën me detyrim dhe migracionin e parregullt, kështu që aktivisht do të bashkëpunojnë me autoritetet shtetërore, organizatat dhe agjencitë ndërkombëtare, veçanërisht sa i përket sigurimit të të dhënave statistikore për trafikimin e qenieve njerëzore;

Të marrin pjesë në fushata të fokusuara mbi trafikimin e qenieve njerëzore dhe çështjeve të përafërta për ndërgjegjësimin e publikut. Iniciativat e këtylla të redaksive do ta fuqizojnë besimin e publikut ndaj gazetarisë.

**PASI QË TA FITONI BESIMIN NGA BURIMET,
ATËHERË LAJMET DO T'JU GJEJNË JU**

Shpeshherë ndërpriten lidhjet midis gazetarëve dhe profesionistëve të cilët i avokojnë të drejtat e njeriut. Disa kanë mëdyshje a t'i publikojnë faktet shokuese për format pamjaftueshëm të njohura të trafikimit të qenieve njerëzore ose punës me detyrim (për shembull, me atë që gazetarëve do t'u ofrojnë qasje deri te viktimat për intervistim). Vendosija e relacioneve të mira midis gazetarëve dhe profesionistëve të cilët i avokojnë të drejtat e njeriut do të ndihmojë në tejkalimin e problemit me mungesën e investigimeve dhe të dhënave të besueshme që u nevojiten gazetarëve ndërsa ky material ka rëndësi jashtëzakonisht të madhe për artikullimin e storjes.

**NDËRTIMI I BESIMIT: MEDIAT DHE ORGANIZATAT JOQEVERITARE MUND TË BASHKËPUNOJNË,
NDËRKAQ TË MOS KOMPROMETOHET PAVARËSIA E REDAKSIVE DHE TË MOS RREZIKOHET
INTEGRITETI I PROJEKTEVE OSE DINJITETI I NJERËZVE TË CILËT JANË VIKTIMA TË TRAFIKIMIT
TË QENIEVE NJERËZORE.**

3.

Praktika të mira

Parimet etike nëpër redaksi kanë rëndësi jashtëzakonisht të madhe që të sigurohet gazetari cilësor. Raportimi për trafikimin e qenieve njerëzore kërkon njohuri, si dhe obligim që të respektohen parimet themelore të raportimit etik.

Parimet kyç të raportimit etik janë:

SAKTËSIA DHE RAPORTIMI I BAZUAR MBI FAKTE.

Shmangni gënjeshtirat, lajmet e rreme dhe informacionet e pa verifikuara.

PAVARËSIA

Veproni sipas vetëdijes tuaj. Mos propagoni dhe mos u bëni zëdhënës të interesave politikë ose të interesave personale të dikujt.

PAANSHMËRIA

Mos harroni t'i shpjegoni të gjitha anët e storjes. Jepuni mundësi të flasin viktimat si dhe ata që u kanë mbijetuar traumave të trafikimit të qenieve njerëzore.

HUMANIZMI

Gazetaria nuk duhet të shkaktoj dëm. Manifestoni bashkëndje në raportimin tuaj. Prezantoni zgjidhje për krizën fizike dhe emocionale të cilën personat e trafikuar e përjetojnë.

LLOGARIDHËNIA DHE TRANSPARENCA

Bëhuni të përgjegjshëm në punën tuaj. Korrigjoni gabimet, çdoherë tregoni se kush jeni dhe bëhuni transparent në veprimet e juaja.

Gazetarët duhet t'i aplikojnë këto vlera themelore në të gjitha aspektet e punës së tyre. mbani mend se gazetarët kanë detyrë specifike që t'u japin respekt njerëzve të cilët u janë nënshtruar traumave, për shkak të trafikimit të qenieve njerëzore. Kodeksi Etik i Shoqatës Nacionale të Fotografëve të Gazetarisë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për shembull, specifikon:

“Të gjitha subjektet trajtoni me respekt dhe dinjitet. Manifestoni mirëkuptim të posaçëm ndaj subjekteve vulnerable, dhe bashkëndjenjë ndaj viktimave të krimit ose tragjedisë. Imponohuni në çastet private të trishtimit vetëm atëherë kur publiku ka nevojë të justifikuar të shoh.”⁵

⁵ Kodeksi është i aksesshëm në: <https://nppa.org/code-ethics>

Pyetje fillestare

Këto pyetje do t'u vinë në ndihmë gazetarëve që t'i identifikojnë rastet potenciale të trafikimit të qenieve njerëzore. Nëse përgjigjja në disa nga pyetjet në vijim është “po”, atëherë veproni me kujdes dhe shfrytëzoni burimet e specifikuar në këtë udhëzues që të këshilloheni.

- 1 Personi me të cilin bisedova a ka qenë i detyruar në një situatë të këtillë përmes dhunës, detyrimit psikologjik ose përmes ndonjë forme tjetër të kontrollit?
- 2 A është personi viktimë e dhunës ose frikësimit?
- 3 A është detyruar personi të jap para?
- 4 A është ekspozuar personi në detyrim nga personi i cili është në pozitë të pushtetshme në raport me të?
- 5 A ta denoncoj rastin në institucionet kompetente për procedim të më-tutjeshëm?

Gazetarët dhe redaktorët duhet t'u shmangen kurtheve të informimit të gabuar, lajmeve të rreme nga rrjetet sociale dhe propagandës për interesa personale. Këtë do ta arrijnë më së miri nëse i respektojnë parimet në vijim:

Përbahuni fakteve, bëhuni skeptik sa i përket statistikës

Storja është tek numrat, megjithatë edhe numrat mashtrojnë. Trafikimi i qenieve njerëzore është një fenomen i kamufluar dhe nuk ka mundësi që të vini deri në numrat e saktë. Rreziku nga të dhënat e fabrikuara është permanent. Gazetarët duhet t'i verifikojnë dhe investigojnë pohimet të cilat përfshijnë numra; duhet t'i verifikojnë faktet që kanë të bëjnë me statistikën dhe kur e do nevoja ta paralajmërojnë publikun për informacionet e pa verifikuara. Mbani mend, vlerësimet më të sigurta vijnë nga autoritetet dhe institucionet në kuadër të Bashkimit Evropian, siç është Komisioni Evropian, Këshilli i Evropës etj.; Organizatat ndërkombëtare siç është Organizata Ndërkombëtare e Punës (ONP), Organizata Ndërkombëtare e Migracionit (IOM); Qendra Ndërkombëtare për Zhvillimin e Politikave të Migracionit (ICMPD), si dhe faktorë të tjerë ndërkombëtar të theksuar në këtë udhëzues. Megjithatë, madje edhe vlerësimet e tyre

dhe mënyra se si kanë ardhur deri te të njëjtat duhet t'i nënshtrohen një rishikimi gazetaresk.

Në vazhdim janë fragmentet nga tekstet e publikuar në portalin e internetit, të cilët e pasqyrojnë shembullin e mirë të raportimit për dukuri alarmante e cila ka të bëjë me mjedisin lokal dhe prek një bashkësi specifike etnike. Numrat e prezantuar kanë mbështetje nga burimet, ndërsa autori e trajton problemin pa e dëmtuar dikë nga grupet vulnerable me të cilët ka të bëjë storja.

Martesat e fëmijëve shënojnë rritje, ndërsa institucionet janë të pafuqishme t'i ndërpresin dhe kontrollojnë!⁶

Rritet numri i martesave të fëmijëve, megjithatë të gjitha institucionet kompetente nuk i trajtojnë të njëjtat si shkelje të të drejtave të fëmijëve, veprojnë në rastet kur ata janë identifikuar në terren, madje nuk mbajnë evidencë të saktë për numrin e tyre – reagojnë nga organizata joqeveritare ROMA S.O.S. Martesat midis të miturve, siç thonë, janë më të shprehura midis nacionalitetit rom. Së këtejmi potencojnë se vetëm në Prilep, në periudhën nga muaji janar deri në muajin qershor të vitit 2015, jo zyrtarisht janë vërejtur më shumë se 20 bashkësi të formuara jashtëmartesore në bashkësinë rome ndërmjet personave të mitur dhe me persona të mitur.

“Martesat e fëmijëve akoma nuk janë artikular mjaftueshëm si problem dhe shpesh ato perceptohen si pjesë e traditës së romëve, përkatësisht si karakteristikë kulturore që duhet të respektohet, të ruhet dhe heshtet. Në mungesë të detyrimeve të veçanta institucionale për parandalimin e këtyre rasteve, praktika tregon se numri i martesave tek romët vazhdimisht është i lartë dhe në krahasim me bashkësitë e tjera është drastikisht më i lartë. Ekzistimi i bashkësive jashtëmartesore midis të miturve dhe me të mitur kontribuon që vajzat ta braktisin procesin arsimor, ndërsa me këtë fuqizohet edhe pabarazia gjinore”-thonë nga organizata joqeveritare nga Prilepi e cila punon me këtë popullatë.

Ata shpjegojnë se të dhënat e pranuar nga Hulumtimi i moduleve të indikatorëve të ndryshëm nga viti 2011 tregojnë se martesat e fëmijëve janë problem aktual në Maqedoni me ç'rast ekzistojnë dallime të mëdha tek bashkësitë e ndryshme etnike. Në kategorinë vajza në moshë nga 15 deri 19 vjeç të cilat janë në martesë ose jetojnë në bashkësi, shkalla nacionale është 4%. Tek maqedonasit është 2%, tek shqiptarët është 6%, ndërsa tek romët është 22%.

“Nëse analizohet gjendja deri më sot atëherë mesa duket numrat janë më të lartë, megjithatë në përqindje mund të shihet një përqindje më e lartë tek popullata rome. Martesat e fëmijëve janë martesat të cilat formohen para se ta mbushin të moshën madhore, ndërsa kufizimi i moshës konform ligjeve është plot 18 vjet. Sipas Kodit Penal, martesat e fëmijëve ndalohen, ndërsa jeta në bashkësi jashtëmartesore midis të miturve dhe me të mitur konsiderohet si vepër penale, përkatësisht paraqet shkelje të të drejtave të fëmijëve. Prandaj nevojitet kujdes serioz institucional për kontrollin dhe verifikimin e gjendjes në terren” – thanë nga ROMA S.O.S.

⁶ Artikulli integral është publikuar më datë 12.07.2015 në: <https://faktor.mk/detskite-brakovi-vo-porast-institutsi-ite-nemokni-da-gi-soprat-i-kontroliiraat>.

Martestat e fëmijëve, sipas tyre, në mënyrë të drejtpërdrejt ndikojnë edhe në zhvillimin psikofizik të fëmijëve por edhe në formimin e personit, e që nga ana tjetër lë pasoja të përhershme në jetën e tyre. “Aktiviteti seksual në moshë shumë të hershme e pengon zhvillimin e organeve gjenitale, mund të shkaktoj sëmundje seksualisht të transmetueshme si dhe shtatzëni të hershme. Përveç kësaj, parashtrohet pyetja për gatishmërinë e tyre të edukojnë dhe arsimojnë generata të ardhshme, si dhe për zhvillimin e tyre personal psikologjik, meqë me lidhjen e martesës në moshë të hershme personat u nënshtrohen situatave të papritura të stresit.” – theksojnë nga organizata joqeveritare ROMA S.O.S.

Legjislacioni ndërkombëtar

Aktivistët i vënë në dukje rekomandimet e Komitetit të KB prej ku duke e shqyrtuar progresin gjatë implementimit të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve nga ana e vendit, theksohet se moshë “minimale” ligjore për martesë është 18 vjet me ç’rast këshillohet që shteti martesat e hershme dhe me detyrim t’i shpall në mënyrë eksplicite si të kundërligjshme, ndërsa personat përgjegjës për këto vepra të dënohen. Në mesin e rekomandimeve kërkohet të implementohet legjislacioni aktual dhe të sigurohet që martesat e fëmijëve nën moshën 18 vjeçare të lejohen vetëm në raste të jashtëzakonshme me urdhër gjyqësor dhe vetëm në rastin kur kjo është në interesin më të mirë të fëmijës. Nga ana tjetër, legjislacioni ndërkombëtar kërkon të zbatohen hulumtime në mënyrë që të vlerësohet numri i fëmijëve të cilët janë nën ndikimin e martesave të hershme dhe të detyrueshme, duke i përfshirë edhe martesat tradicionale të cilat nuk janë regjistruar tek autoritetet kompetente, të miratohen masa konkrete për reduktimin dhe çrrënjosjen e praktikës së këtillë.

Luftoni kundër lajthitjeve

Një mosmarrëveshje e shpeshtë e cila rezulton nga fokusi i medias ndaj seksit dhe senzacionalizmit konsiston me atë se trafikimi i qenieve njerëzore më së shpeshti ka të bëjë me eksploatimin seksual dhe më së shumti iu ndodhë grave dhe vajzave. Në të vërtetë, në disa vende të Evropës, pjesa më e madhe e viktimeve të identifikuar të trafikimit të qenieve njerëzore janë viktime të eksploatimit të punës, dhe jo të eksploatimit seksual. Eksploatimi seksual (përfshirë këtu edhe burrat dhe djemtë) është problem i madh të cilin duhet ta luftojmë, por jo edhe me çmimin e shpërfilljes së formave të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore, siç është trafikimi me qenie njerëzore me qëllim të eksploatimit të punës, trafikimi me qenie njerëzore me qëllim të krimit të detyruar, lypjes së detyruar, martesave të detyruara etj. Artikulli i radhës është një shembull i raportimit të drejt për rastin i cili, me sa duket, ka të bëjë me trafikimin e qenieve njerëzore me qëllim të eksploatimit të punës. Storja është humanizuar dhe jep një mesazh të qartë se njerëzit gjatë kërkimit të punës shpeshherë mund të bëhen viktime të formave të ndryshme të trafikimit të qenieve njerëzore.



Unë quhem Samir, dhe isha viktimë e trafikimit me genie njerëzore!⁷

Më premtoi punë dhe pagë të shkëlqyeshme. Thash - me vetveten – ia nisi për së mbari! Tani e di se isha i burgosur, skllav.

Unë quhem Samir. Jam 20 vjeçar. Para 3 vitesh kam e kryer arsimin e mesëm dhe fillova të kërkoj punë. Nga miqtë e kuptova se jashtë vendit jeta është më e mirë, fitohen më shumë para dhe thash me vetvete të provoj. Kërkoja nëpër shpallje dhe gjeta një njeri i cili ndërmjetësonte për punë jashtë vendit. Më tha se do të më punësojë në një fabrikë për motorë. Më premtoi pagë të shkëlqyeshme. Thash – me vetveten – ia nisi për së mbari! Kisha edhe pak frikë, vend i panjohur, atje nuk kam askënd, por njeriu më premtoi se do të më gjejë edhe akomodim ndërsa për udhëtimin fare të mos mërzitem. Më siguroi edhe vizë pune madje edhe ma tregoi. Kjo i bindi edhe prindërit e mi se çdo gjë do të jetë në rregull dhe se do të më hapet rruga për një jetë më të bukur.

Një mëngjes u nisëm dhjetë persona me një furgon dhe të gjithë ishim të shqetësuar. Ndërmjetësuesi na i mori pasaportat qysh në kufi, që ta kalojmë kufirin, dhe më nuk i pamë. Qysh kur arritëm disi më dukej se nuk është çdo gjë në rregull. Na vendosën në një shtëpi të izoluar nëpër dhoma nga katër persona me krevat të vjetër marinari. Së shpejti zbulova dhe nuk është çdo gjë ashtu siç mu premtua, na çuan të punojmë në një objekt në ndërtim. Ndërmjetësuesi na bindte se nuk ka pozita të lira në fabrikën për motorë, kështu që përkohësisht duhet të punojmë në ndërtimtari, derisa ta rregulloj punën e premtuar. Punoja nga 12 orë në ditë, ndonjëherë edhe më shumë, nga paga nuk pash asgjë, më bindte se duhet të punoj dhe të përfitoj që t'ia paguaj rrugën dhe shërbimet e tij, dhe se ai u dërgon familjes time diçka nga fitimet e mia. Tani e di se isha i burgosur, skllav. Nuk na lejonin të dilnim nga shtëpia, ndonjëherë më lejohej të paraqitem në shtëpi por me kërcënimin se nëse ankohe m do të më lënë në rrugë dhe do të përfundoj në burg në një vend të huaj pa e ditur askush se ku jam.

⁷Artikulli është publikuar më datë 17.10. 2020 në: <https://skopjeinfo.mk/moeto-ime-e-samir-i-bev-zhrtva-na-trgovija-solugje>.

Si shpëtova? Megjithatë paska njerëz në këtë botë. Pas 6 muajsh isha pa shpresa, pa dëshirë për jetë. Më transferuan të punoj në një objekt tjetër. Një grua në moshë rregullisht e shëtiste qenit rreth kantierit. Një ditë qeni vrapoi drejt meje dhe filluam të bisedojmë, aq sa mundeshim të kuptohemi meqë gjuhën e tyre nuk e flisja mirë. Më këshilloi të ikë gjatë orarit të punës dhe më ndihmoi ta denoncoj rastin në polici.

Kjo është vetëm njëra nga shumë storjet në botën e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore me qëllim të eksploatimit të punës.

Samiri mendon se njerëzit shumë pak mendojnë për rrezikun i cili fshihet pas vetëm një klikimi. “Kur do të hasni ndonjë shpallje në Internet nuk prisni që dikush t’ju mashtroj. Nëse atëherë dikush do të më këshillonte, gjithsesi se nuk do të përjetoja momente aq të vështira. Megjithatë, pata fat dhe shpëtova”.

Bëhuni pozitiv dhe artikuloni zgjidhje

Është me rëndësi që fokusi të vendoset mbi rezistencën e njerëzve të cilët mund të jenë viktimat të trafikimit të qenieve njerëzore dhe rimëkëmbjen e tyre. Viktimat që ia kanë dalë të rehabilitohen shpjegojnë storje të pabesueshme. Prezantimi i fakteve pozitive dhe të balancuara kontribuon për një besim më të madh të publikut për atë që e flisni. Hulumtoni politikat publike dhe shtrojani vetvetes pyetjen çka dhe si mund të përmirësohet. Teksti i radhës mediatik e ilustron shembullin pozitiv të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore të cilat janë rehabilituar me ndihmën e institucioneve në Holandë të cilëve u është dhënë shansi i dytë për një jetë normale.

Restoranti në Amsterdam punëson viktimat të trafikimit të qenieve njerëzore që t’u ndihmoi të kenë një jetë normale⁸

“Kur grave ua dhamë certifikatat, qanin dhe kishin dëshirë t’i vënë në kornizë”, tha Tus Himskerk-Shep. “Kjo është vetëm një copë letre, por atë që e kanë arritur i bën të ndjehen se diçka vlejné, e që është pikërisht ajo që u është marrë si viktimat të trafikimit të qenieve njerëzore. Dinjiteti i këtyre njerëzve me të vërtetë u është vjedhur – nuk je njeri i mirëfilltë, ti je produkt”.

Himskerk-Shep është drejtoreshë e degës holandeze të Not For Sale, një organizatë globale e cila punon në parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore. Ajo udhëheq programe kulinare në Amsterdam, të cilat synojnë t’i rehabilitojnë ata të cilat kanë qenë të detyruara për eksploatim seksual në Rrugën e Kuqe. Kur e përfundojnë kursin katër javorë për gatim, higjienë kulinare dhe sjellje të drejtë marrin certifikatë.

U njoftova me Himskerk-Shep në Dignita, restorantin të cilin Not For Sale e menaxhon që të siguroj përvojë të mirëfilltë në kuzhinë për nxënësit e vet. Përreth vazove të ndritshme dhe dërrasave të kuqe, vërejtja disa ornamente me formë të diamantit.

“I zgjodhëm diamantet, meqë kështu i perceptojmë vajzat të cilat kalojnë këtu”-tha Himskerk-Shep përdërisa e pi filxhanin me çaj nenexhiku. “Në fillim janë të ashpër nëpër skaje por kur do të fillosh të punosh në to, me të vërtetë shkëlqejnë”.

⁸ Artikulli integral është publikuar nga ana e Radio MOF, 30.05.2016. <https://www.radiomof.mk/restoran-vo-amsterdam-vrabortuva-zhrvti-na-trgovija-so-lugje-za-da-im-pomogne-da-vodat-normalen-zhivot/>

Ndiqni paratë

Industria e trafikimit të qenieve njerëzore mundëson punë me detyrim e cila siguron produkte më të lira për gjithsecilin. Bëhet fjalë për një industri globale për të cilën nevojiten hetime të thella.

Ka disa shembuj të shkëlqyeshëm të punës investigative – siç është filmi dokumentar “Njerëz në shitje” i Bi-Bi-Si9 i emituar në vitin 2017.

Megjithatë, mediat mund të investigojnë se si shërbimet lokale (auto - lavazhet, sallonet e manikyrit, sallonet e masazhit, feramat dhe kantieret) përdorin modele të biznesit të ndërtuara mbi krahun e lirë të punës. A janë ata persona potencialisht të trafikuar? Gazetarët mund t’i ndjekin paratë dhe të kërkojnë materiale që kanë të bëjnë me trafikimin e qenieve njerëzore. Dëgjuesve/lexuesve mund t’iu tregojnë se si ne të gjithë, në njëfarë mënyre, jemi të lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore. Kjo do tua tërheq vëmendjen njerëzve.

“Gazetarët të cilët bëjnë investigime për trafikimin e qenieve njerëzore çdoherë duhet ta kenë parasysh se duhet të jenë shumë të kujdesshëm gjatë veprimeve të tyre. Gjatë investigimit do të ballafaqohen me tema në të cilat janë involvuar kriminel të rrezikshëm, ndërsa për fat të keq, ligjet në Maqedoninë e Veriut gazetarët nuk i mbrojnë në masë të mjaftueshme, madje as sigurinë e tyre.”

Gazetar nga Maqedonia e Veriut

Ofroni shpresë

Publiku e ka lehtë t’i imagjinoj njerëzit të cilët janë viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore ose punojnë punë me detyrim si persona pa ndihmë me pasoja të përhershme. Megjithatë një gjë e këtyllë nuk është çdoherë e saktë. Gazetaria me të cilën theksohet rezistenca e njeriut dhe e cila flet për atë se sa njerëzit kanë pasur sukses të shpëtojnë nga tragjedia e trafikimit të qenieve njerëzore dhe sërish ta fillojnë jetën nga e para, në të vërtetë është një naracion ndryshe të storjes. Shembulli në vijim është raportimi pozitiv në këtë drejtim.

9 Filmi dokumentar është i aksesshëm në: <https://www.youtube.com/watch?v=uDhYxVGTpgo>

Luga e çajit si shpëtim nga martesat me detyrim

Aeroporti dhe aktivistët për të drejtat e njeriut në Geteborg i këshillojnë të gjitha vajzat të cilat janë viktime potenciale të kidnapimit me qëllim të lidhjes së martesës ose synetit që të vënë lugë çaji në brekë.

Përkatësisht, punonjësit e aeroportit janë të trajnuar si të reagojnë në situata të këtilla. Luga e çajit do t'i aktivizojë detektorët e metalit, dhe për këtë vajzat do të mënjahen ose do të dërgohen në kabinë që të kontrollohen. Atëherë kanë mundësi t'u tregojnë nëpunësve se për çka bëhet fjalë.

Linja nacionale Suedeze për ndihmë ka pranuar 139 thirrje, me ç'rast janë denoncuar martesat me fëmijë ose martesat me detyrim. Aktivistët i inkurajojnë edhe qytetet e tjera ta ndjekin shembullin e Geteborgut dhe ta aprovojnë iniciativën "lugë çaji" që t'i mbrojnë vajzat.

Idenë e inicioi Shoqata Britanike për Bamirësi "Karma Nirvana", e cila njoftoi se kjo taktikë tanimë ka shpëtuar një numër të madh vajzash në Britaninë e Madhe nga martesat me detyrim. Ata kanë kërkuar edhe dënime më të larta për martesat me detyrim pas zbulimit nga ana e policisë se në tre vitet e fundit ka pasur 3.500 raste.¹⁰

Udhëzime për intervistim

Fenomeni i trafikimit me qenie njerëzore meriton mbulim mediatik, por meqë bëhet fjalë për krim të kamufluar, shpeshherë nevojitet një sasi e madhe e resurseve në mënyrë që të mbështetet gazetaria investigative. Qasja deri te viktimat e riintegruara ndonjëherë është e vështirë, ndërsa pikërisht zëri i tyre ka një rol jashtëzakonisht të madh që storja të prezantohet në lajmet kryesore.

MBANI MEND

Media disponon fuqi jashtëzakonisht të madhe. Njerëzve mund t'u pëlqejë kur do t'u afrohet ndonjë raportues, ndërkaq pa e kuptuar plotësisht rrezikun për vetveten dhe për të tjerët meqë do të jenë nën thjerrëzën e publikut. Kjo vlen për njerëzit që janë përfshirë në vorbullën e trafikimit të qenieve njerëzore po aq sa vlen edhe për njerëzit të cilët kanë përjetuar fatkeqësi humanitare, luftë ose ndonjë ngjarje tjetër traumatike.

Gazetarët duhet të jenë sa më transparent në marrëdhënien që e ndërtojnë me burimet e tyre, dhe veçanërisht me viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore. Gazetarët duhet:


- Të konstatojnë se ndonjë person a është fëmijë (nën moshën 18 vjeçare);
- Ta vlerësojnë fragjilitetin e burimit (veçanërisht nëse bëhet fjalë për njerëz të rinj, ose njerëz të cilët kanë qenë viktime të traumës ose dhunës);

¹⁰ Artikulli është publikuar në: <https://www.fakulteti.mk/news/07062018/lazhichkata-kako-spas-od-prisilen-brak> më datë 07.06.2018

- Ta respektojnë privatësinë. Secili ka të drejtë për privatësi dhe të trajtohet me respekt, dhe veçanërisht fëmijët;
- Të mbajnë llogari që fëmijët të intervistohen në prezencë të personit të rritur përgjegjës ose kujdestarit;
- Tua shpjegojnë procesin e raportimit dhe tu shpjegojnë pse është e rëndësishme storja e tyre;
- Ta shmangin, përveç në raste të jashtëzakonshme, shtrembërimin dhe mashtrimin kur raportojnë për çështjet që kanë të bëjnë me trafikimin e qenieve njerëzore.

MBANI MEND

Nëse viktima nuk ka prind ose kujdestar, ose është analfabet dhe nuk mund të lexojë, si dhe nëse organizata kompetente që e avokon personin e mbijetuar nuk e gëzon besimin, atëherë gazetari duhet të mbështetet në koshiençën e vet dhe në gjykimin e vet personal. Ky është momenti kur në vepër duhet të manifestohet etika.



Në vijim lista plotësuese e pyetjeve nga aspekti etik të cilat gazetarët duhet t’ia parash-trojnë vetvetes kur intervistojnë viktima të trafikimit të qenieve njerëzore:

- A e shpjegova pse po e bëjë këtë intervistë dhe cili është qëllimi i storjes time? A isha plotësisht transparent për qëllimet e mia?
- A jam kujdesur që ta mbroj personin (për shembull, ndonjë person të ri ose ndonjë person tjetër në rrethana fragjile) të jetë i vetëdijshëm për

pasojat e mundshme për shkak të publikimit të informacioneve që do të m'i jap?

- A jam i sigurt se bashkëfolësi tërësisht i kupton kushtet e intervistës sonë, dhe çka në të vërtetë nënkupton kur do t'ia them informacionet jozyrtare ose informacionet që nuk janë për t'i cituar, si edhe kur do të përdor ndonjë nocion tjetër profesional?
- Nëse burimi parashtron kushte para se të pajtohet për intervistë, atëherë cilat janë kufizimet e mia? A duhet t'i paguaj shpenzimet e burimit që ta realizojmë intervistën? Cilat mund të konsiderohen si shpenzime legjitime që mund t'ia paguaj?
- A do të pajtohem unë që burimit t'i ofroj mbështetje plotësuese, për shembull, ndihmë për avokim juridik, nëse paraqiten probleme si pasojë e raportimit tim?
- A kërkoja leje para se të bëj ndonjë foto ose video-regjistrim?
- A parashtrova pyetje të duhura, mos vallë nxita përjetim të sërishëm të përvojave traumatike, a ia mundësova bashkëbiseduesit të flas lirisht?
- A u fokusova në aspektet pozitive të përvojës së bashkëbiseduesit dhe a ia sqarova bashkëbiseduesit se ka të drejtë ta kontrolloj artikullin tim, nëse rastësisht përmban gabime faktike, para se ta publikoj?
- A i parashtrova të gjitha pyetjet dhe a i pranova përgjigjet në të gjitha pyetjet e parashtruara? A isha i kujdesshëm dhe sensitiv dhe a i mbrojtja interesat e bashkëbiseduesit?

Anonimiteti

...është e drejtë të cilën duhet ta gëzojnë ata të cilëve u nevojitet, por kjo e drejtë asnjëherë dhe askujt nuk i mundësohet në mënyrë rutinore. Kur bëhet fjalë për trafikimin e qenieve njerëzore, mbrojtja e njerëzve më vulnerabil imponon që gazetarët të mbajnë llogari që tua sigurojnë viktimave anonimitetin, madje edhe atyre të cilët do ta ekspozojnë vetveten në rrezik plotësues nëse iu zbulohet identiteti, pavarësisht nëse kanë kërkuar anonimitet ose jo.

A duhet gazetarët t'i shkelin rregullat në emër të humanizmit?

Ndonjëherë, gazetarët me burimet e tyre mund të ndërtojnë marrëdhënie dykahëshe, e që nga ana tjetër mund ta rrënojnë themelin etik të punës së tyre.

Në vitin 2014, gazetari televiziv suedez Fredrik Eneval u miqësua me një refugjat 15-të vjeçar sirian, gjatë detyrës së tij që të raportojë për flukset e migacionit. Ai dhe stafi i tij vendosën ta ndihmojnë këtë djalë dhe ta sjellin në Suedi. Filmin që ata e regjistruan lidhur me kalvarin e këtij djali u emetua në televizionin shtetëror suedez, dhe hasi në mirëkuptim të gjerë tek publiku, megjithatë, gazetari u ndoq penalisht dhe u dënua për kontrabandë me njerëz. Veprimi i tij nxiti debat të ashpër në kastën e gazetarëve në lidhje me rolin e gazetarëve gjatë raportimit – a duhet të bëhen bashkëpjesëmarrës në storjet ose të mbeten vetëm si vëzhgues?



Shmangni përdorimin e fotografive ose regjistrimeve të cilat luajnë me letrën e senzacionalizmit, ndërhyrjes në privatësi dhe vojerizmit

4. Udhëzime për fotogazetari



Çdo gazetar pretendon të realizoj intervistë, fotografi ose video-regjistrim me njerëzit të cilët për momentin janë në një lloj eksploatimi ose në punë me detyrim. Dramat dhe tragjeditë e rasteve me vdekje në mesin e migrantëve, prej të cilëve shumica janë përfshirë nga trafikimi me qenie njerëzore, u bënë burim i pasur i fotove mbresëlënëse, megjithatë një pjesë e madhe e tyre janë kontroverse.

Mos harroni se prezenca e ekipeve gazetareske në situata **në të cilat** gjenden njerëz fragjil, të frikësuar dhe të eksploatuar mund të jetë traumatike **për ata**. Gazetarët duhet të bëjnë çdo gjë brenda mundësive të tyre që të krijojnë atmosferë të sigurtë kur ata intervistojnë ose regjistrojnë njerëz të cilët kanë qenë viktimë të trafikimit të qenieve njerëzore.

Gazetaria suportohet nga përdorimi i fotove mbresëlënëse gjatë narracionit të storjeve, por me rëndësi esenciale është që mediat të jenë të kujdesshme të mos krijojnë përshtypje të përcipte me çka mund t'i stimuloj dhe përforcoj stereotipat (duar të lidhura, çorape rrjeti dhe take të larta me ndriçim të kuq, klube të natës etj.).

Çdo herë kërkoni leje që të fotografoni ose regjistroni persona të caktuar, edhe pse një gjë e këtillë nuk është e nevojshme nëse i fotografoni ose regjistroni në ndonjë mjedis publik. Nëse ka mundësi, paraprakisht kërkoni leje me shkrim.

Shmangni përdorimin e fotografive të cilat janë klishe, si për shembull vajzë me zinxhirë ose njeri me barkod, fëmijë pas grilave ose në bordel. Imazhi i gruas me barkod mund të ndihmojë që storja të humanizohet?

Imazhet e këtilla kontribuojnë në drejtim të stereotipave të trafikimit të qenieve njerëzore dhe mund të çojnë në konkluzion të gabuar. Për shembull, një numër i madh i viktimave të trafikimit me qenie njerëzore janë njerëz të cilët e kanë përjetuar gjendjen e këtillë dhe tani rimëkëmben. Shumica e tyre nuk kanë janë detyruar me vrazhdësi në eksploatim, por janë manipuluar emocionalisht dhe janë bërë të varur.

Shmangni imazhe eksplicite të dhunës. Janë shumë të rralla rastet kur pasqyrimi i dhunës ekstreme mund të jetë me interes publik. Marrë në përgjithësi, redaktorët dhe regjistruerit duhet të mendojnë se në ç'masë është i pranueshëm përdorimi i regjistrimit me lëndime trupore? Ku duhet të tërhiqet vija? A është e arsyeshme të pasqyrohen vrugë, mavijosje, duar dhe këmbë të thyera të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore që ta shpjegojmë storjen?



Për shkak të aftësisë së tyre të depërtimit deri te publiku, mediat janë mekanizëm i fuqishëm për formësimin e perceptimit të trafikimit të qenieve njerëzore. Ndonjëherë gazetaria dështon kur duhet të mbahet llogari për mbrojtjen e të drejtave të viktimave

5.

Praktika të gabuara

Këto janë disa nga shembujt të praktikave të gabuara gjatë raportimit:

Thjeshtëzimi i fenomenit të trafikimit të qenieve njerëzore

Mos i impononi stereotipat e trafikimit të qenieve njerëzore si skllever në pranga, si dikotomi të viktimave dhe eksploatues. Pasqyra e thjeshtëzuar dhe gjuha e cila flet për “sklleverit seksual”, “tregun e mishit”, “gratë që e shesin vetveten” dhe ngjashëm e dehumanizojnë dhe i hedhin hije kompleksitetit të fenomenit të trafikimit të qenieve njerëzore. Shembulli në vijim (fragment nga një tekst i publikuar në media) e ilustron qasjen e këtillë negative të raportimit.

Një rumune tre muaj ka qenë skllave seksuale në Kondovë¹¹

Një rumune tre muaj ka qenë skllave seksuale në Kondovë. Një banorë 23 vjeçar nga ky fshat e ka njoftuar në Gjermani dhe i ka premtuar se do të martohet me atë kur do të mbërrinjë në shtëpi. Por, në fshatin e Shkupit është ballafaquar me ankth të mirëfilltë. Bashkëshorti në thonjëza ia ka marrë dokumentet, e ka detyruar të punoj dhe e ka abuzuar fizikisht dhe seksualisht.

“Vendosja në kallëp” e viktimave

Nuk është e thënë që të gjitha viktimat të jenë njerëz pa rrugëdalje pa vullnetin dhe agjendën e tyre. Grupet e njerëzve janë të ndryshme: sa më i madh që është grupi, aq më i madh është edhe diversiteti i brendshëm. Detyra e gazetarit është ta zbuloj diversitetin në këto grupe, dhe jo ti proklamoj disa nga tiparet e mbrojtura të këtyre njerëzve të cilat e karakterizojnë grupin në përgjithësi.

Përdorimi i fjalorit, narracionit dhe imazheve stereotipe

Të raportohet për trafikimin e qenieve njerëzore dhe gjatë kësaj të mos skandalizohet tema do të thotë të mos përdoren dhe të mos ilustrohen imazhe në kontekstin seksual me qëllim që të pasqyrohet viktimata. Shmangni përforsimin

¹¹ Artikulli integral është publikuar më datë: 25.05.2014, në: <https://kanal5.com.mk/romanka-tri-meseci-bila-seksual-na-robinka-vo-kondovo/a206183>.



e stereotipave etnike. Në vijim një shembull negativ të ilustrimit të storjes përmes fotografisë jo përkatës e cila e pasqyron dhunën.

Diskursi i paracaktuar gjinor

Diskursi i cili sipas përkufizimit përdoret për përshkrimin e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore e thekson gjininë femërore. Apostrofimi i tepërt i gjinisë femërore si viktimë mund të çojë deri në keqkuptim në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore në tërësi dhe t'i përforcojë paragjykimet dhe perceptimet e grave si viktimat. Nëse përmendet gjinia, atëherë duhet të përfshihet edhe gjinia mashkullore dhe identifikimet e tjera gjinore, me çrast rritet individualiteti i personit të trafikuar.

Përdorimi i gabuar dhe joadekuat i terminologjisë

Mediat aplikojnë diskurs të ndryshëm kur raportojnë për rastet e trafikimit të qenieve njerëzore. Shpeshherë vërehet përdorimi i nocioneve jo përkatëse dhe diskriminuese, si për shembull, “skllëvër të bardhë”, ose trafikimi i qenieve njerëzore unifikohet me kontrabandën me njerëz, edhe pse në të vërtetë bëhet fjalë për dy fenomene të ndryshme. Këto narracione të ndryshme ndonjëherë janë sfidë për profesionistët dhe gazetarët e medias, meqë informimi i gabuar mund të krijoj pasqyrë të gabuar ose të paqartë për rastin në fjalë. Prandaj është jashtëzakonisht e rëndësishme që gazetarët ta njohin mirë këtë fenomen dhe ta bëjnë dallimin me fenomenet e ngjashëm të tjerë dhe me veprat kriminale. Ja një shembull nga mediat, me ç’rast në tekst mund të konkludohet se nocioni trafikimi i qenieve njerëzore është përdorur në mënyrë jo përkatëse ose në mënyrë të paqartë.

Në afërsi të Libisë u fundos gomonia me 120 imigrantë ilegal: u mbytën 117 persona

Në detin Mesdhe, në afërsi të Libisë, u fundos një gomone e cila transferonte 120 imigrantë ilegal me ç'rast u mbytën 117 persona nga të cilët dy foshnje dhe një grua shtatzënë. Sipas lajmeve të publikuara në mediat italiane, gomonia e cila lundroi nga qyteti libian Garabuli pas përafërsisht 10 orë lundrim filloi të lëshonte ajrin dhe u fundos në 45 milje nga kryeqyteti liberian Tripoli. Nuk u intervenua për tre orë pas fatkeqësisë, pas çka 117 persona nga të cilët shumica nga vendet e Afrikës Perëndimore, e humbën jetën në det.

Tre orë pas fatkeqësisë me ndihmën e helikopterit të Forcave Detare Italiane, u shpëtuan tre migrantë, dy nga Sudani dhe një nga Gambia, të cilët pastaj u dërguan në ishullin Lampeduza në Jug të Italisë. Migrantët e shpëtuar janë transferuar për mjekim për shkak të hipotermisë. Forca Detare Italiane dhe Rojet Bregdetare Libiane brenda natës realizuan aktivitete për kërkimin dhe shpëtimin në vendin e ngjarjes në ujërat territorial të Libisë, megjithatë nuk arritën të shpëtojnë asnjë imigrant tjetër ilegal. Zëvendës Kryeministri dhe Ministri i Punëve të Brendshme i Italisë Mateo Salvini vendi i të cilit i mbylli portet e tij për migrantët të cilët arrijnë përmes detit Mesdhe tha: - “Në afërsi të Libisë përsëri ka viktimë. Përderisa portat evropiane janë të hapura, përderisa disa u ndihmojnë trafikantëve me qenie njerëzore, kontrabandistët me njerëz do të vazhdojnë të vrasin dhe të merren me këtë punë.”



6.

Linqe dhe kontakte

Kontakte nga institucionet dhe organizatat relevante në Maqedoninë e Veriut

INSTITUCIONI/ORGANIZATA	KONTAKTI
<p>Komisioni Nacional për Luftë Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Migracionit Ilegal</p> <p>http://nacionalnakomisija.gov.mk/mk/</p>	<p>Zyra e Koordinatorit Nacional për Luftë Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Migracionit Ilegal</p> <p>Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Maqedonisë së Veriut</p> <p>Adresa: Dimçe Mirçev nr. 9, 1000 Shkup</p> <p>Tel. +389 02 3238-595, +389 02 3143-241</p> <p>Faks: +389 02 3142-788</p>
<p>Ministria e Punëve të Brendshme</p> <p>Kontakte me mediat https://mvr.gov.mk/portparoli-na-svr</p> <p>Njësia për Trafikimin e Qenieve Njerëzore dhe Kontrabandimin me Migrantë</p> <p>Departamenti për Punë Kufitare dhe Migracion</p> <p>https://mvr.gov.mk/profilepage/sektor-za-granichni-raboti-i-migracii</p>	<p>Adresa: Dimçe Mirçev nr. 9, 1000 Shkup</p> <p>Zëdhënësi</p> <p>Tel: +38970274499</p> <p>mvrjavnost@gmail.com</p> <p>Tel: +389 02 314 23 77</p> <p>Tel: +389 02 333 40 36</p>
<p>Ministria e Punës dhe Politikës Sociale http://mtsp.gov.mk/</p> <p>Zyra e Mekanizmit Nacional për Referim (MNR)</p> <p>Qendra për Punë Sociale</p>	<p>Adresa: Dame Gruev 14, 1000 Shkup</p> <p>Tel: +389 02 3129 308 + 389 02 3106 663</p> <p>MNR Koordinatori</p> <p>Tel: +389 02 3 106 443</p> <p>nmuofficemk@yahoo.com</p> <p>Kontakti: https://mtsp.gov.mk/institucii.nspk</p>

INSTITUCIONI/ORGANIZATA	KONTAKTI
<p>Prokuroria Themelore Publike për Ndjekjen e Krimin dhe Korrupsionit të Organizuar http://jorm.gov.mk/osnovno-javno-obvinitelstvo-za-gonen/</p>	<p>Prokurori Publik</p> <p>Udhëheqësi i Njësisë Nacionale për Luftë Kundër Kontrabandimit të Migrantëve dhe Trafikimit të Qenieve Njerëzore</p> <p>Adresa: Kej Dimitar Vllahov p.n., 1000 Shkup</p> <p>tel.+389 023298 -288 faks.+389 023219 – 881 jorm@jorm.org.mk</p> <p>Shërbimi për Marrëdhënie me Publikun press@jorm.mk</p>
<p>Zyra e Raportuesit Nacional për Trafikimin e Qenieve Njerëzore dhe Migracionin Ilegal pranë Avokatit të Popullit</p>	<p>Raportuesi Nacional për Trafikimin e Qenieve Njerëzore dhe Migracionin Ilegal pranë Avokatit të Popullit Avokati i Popullit</p> <p>Adresa: rr. Maqedonia nr. 19, 1000 Shkup Tel: +389 02 3129335 Faks: +389 02 3129359 contact@ombudsman.mk</p>
<p>Qendra e Pranimit të të Huajve</p>	<p>Tel/Faks:+389 02 3142613</p>
<p>Shoqata për Veprim Kundër Dhunës dhe Trafikimit të Qenieve Njerëzore Porta e Hapur – “La Strada” Shkup www.lastrada.org.mk</p> <p>Qendra për Persona-Viktima të Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Viktima të Dhunës Seksuale</p>	<p>Tel/Faks:+389 02700107 lastrada@lastrada.org.mk</p> <p>SOS Linja: 080011111</p>
<p>Shoqata për Mundësi të Barabarta “Semper” http://www.semper.org.mk/</p>	<p>Adresa: Rr. Sisak nr. 23, 7000 Manastir Tel: +389 47/252-095 +389 47/251-000 +389 70/339-296</p>
<p>Shoqata për Mundësi të Barabarta “Qasje e Barabartë” www.ednakvimoznosti.mk</p>	<p>Adresa: Dobromir Hrs nr.3, 1000 Shkup Tel: + 389 02 2781244 + 389 70323671 ednakov_pristap@yahoo.com</p>

INSTITUCIONI/ORGANIZATA	KONTAKTI
Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj https://myla.org.mk/	rr. Donbas nr. 14/6 1000 Shkup Tel: +389 02 3220 870 contact@myla.org.mk
Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë së Veriut http://ckrm.org.mk/	Adresa: Bul. Koço Racin nr. 13, 1000 Shkup Tel: +389 02 311 43 55 mrc@redcross.org.mk
Qendra për Iniciativa Qytetare http://cgimk.org.mk/	Adresa: rr. Dimo Narednikot p.n., 7500 Prilep Tel: + 389 48 425 125 + 389 48 400 480 ccimk@cgimk.org.mk
Këshilli Nacional për Barazi Gjinore http://sozm.org.mk/	Adresa: 11 tetori 17, 1000 Shkup Tel: +389 02 3134390 +3892 3238814 Sozm@t-home.mk; sozmrc@unet.org.mk
Organizata Joqeveritare Gazetarë për të Drejtat e Njeriut www.jhrmk.org	Adresa: Strasho Pinxhur 7, 1000 Shkup Tel: +389 70 233917 detstvo@detstvo.org.mk
Zyra Programore e Këshillit të Evropës në Shkup https://www.coe.int/en/web/skopje Instrumenti Horizontal i BE dhe Këshillit të Evropës http://horizontal-facility-eu.coe.int	Adresa: Qendër biznesi Soravia Filip Vtori Makedonski 3, 1000 Shkup Tel: +389 02 3100 330 horizontal.facility@coe.int

Institucione dhe organizata relevante ndërkombëtare

Ekziston një numër i madh i organizatave ndërkombëtare dhe organizatave joqeveritare, si dhe grupe lokale dhe rajonale të përfshira në luftimin me fenomenin trafikimi i qenieve njerëzore. Në vazhdim disa prej tyre të cilat mund ti kontaktojë media.

Këshilli i Evropës është organizatë prijëse për të drejtat e njeriut në kontinent. Ai ka 47 vende-anëtare, nënshkruese të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Marrëveshjes për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, demokracisë dhe sundimin e ligjit. Konventa për veprim kundër trafikimit të qenieve njerëzore, e hartuar nga Këshilli i Evropës, parashikon vendosjen e mekanizmit të pavarur të monitorimit ("GRETA") i cili përbëhet nga grupi i ekspertëve të cilët e vlerësojnë harmonizimin e anëtarëve me dispozitat e saj.

Council of Europe (CoE)

<https://www.coe.int/en/web/portal>

Kontakti: <https://www.coe.int/en/web/portal/media-contacts>

E-mail: pressunit@coe.int

Qendra Ndërkombëtare për Zhvillimin e Politikave të Migracionit është organizatë ndërkombëtare dhe ndërqeveritare në të cilën kanë aderuar 18 vende anëtare, në mesin e të cilave edhe Maqedonia e Veriut. ICMPD përmban Program për luftë kundër trafikimit të qenieve njerëzore, i cili implementon projekte, ndihmon në ndërtimin e kapaciteteve dhe në realizimin e hulumtimeve.

The International Centre for Migration Policy Development (ICMPD)

<https://www.icmpd.org/home/>

Kontakti: Gonzagagasse 1, 1010 Vienna Austria

Tel: +43 1 504 46 77 0 Fax: +43 1 504 46 77 23 75

E-mail: media@icmpd.org

Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR) është organizatë globale e përkushtuar në mbrojtjen e të drejtave dhe ndërtimin e ardhmërisë më të mirë për refugjatët, për komunitetet e shpërngulura me forcë dhe për njerëzit pa shtetësi, me synimin primar të mbrohen të drejtat dhe mirëqenia e njerëzve të cilët janë detyruar t'i braktisin shtetëpitë e tyre.

The United Nations High Commissioner for Refugees (UNHCR)

<http://www.unhcr.org/>

Kontakti: United Nations High Commissioner for Refugees Case Postale 2500 CH-1211

Genève 2 Dépôt Switzerland

Tel: +41 22 739 8111 (automatic switchboard) Fax: +41 22 739 7377

E-mail: <http://www.unhcr.org/international-media-contacts.html>

Organizata Ndërkombëtare e Punës (ONP) i bashkon qeveritë, punëdhënësit dhe punëtorët nga 187 vende-anëtare që t'i përcaktojnë standardet e punës, të zhvillojnë politika dhe të krijojnë programe për avancimin e kushteve të punës për të gjitha gratë dhe burrat.

The International Labour Organization (ILO)
<http://www.ilo.org/global/lang-en/index.htm>

Tel +41 22 799 7912 Fax: +41 22 799 8577

Ueb: ilo.org/newsroom

E-mail: newsroom@ilo.org

Organizata Ndërkombëtare për Migracion (IOM) është organizatë ndërqeveritare prijëse e cila vepron në fushën e migracionit dhe bashkëpunon ngushtë me partnerë qeveritar, ndërqeveritar dhe joqeveritar. Aktivitetet e përfshijnë avancimin e instrumenteve juridike ndërkombëtare që kanë të bëjnë me migracionin, hartimin e politikave dhe udhëzimeve, si dhe me mbrojtjen e të drejtave të migrantëve.

The International Organization for Migration (IOM)

<https://www.iom.int/>

E-mail: <https://www.iom.int/media-contacts>

Rrjeti etik i gazetarëve është koalicion prej më shumë se 60 grupe të gazetarëve, redaktorëve, pronarëve të mediave dhe grupeve për mbështetjen e medias nga mbarë bota të cilët propagojnë se parimet e gazetarisë etike janë universale dhe janë resurs i rëndësishëm në lidhje me respektimin e demokracisë dhe të drejtave të njeriut.

The Ethical Journalism Network (EJN)

<https://ethicaljournalismnetwork.org/>

Kontakti: <https://ethicaljournalismnetwork.org/who-we-are/contact>

Disa iniciativa dhe resurse kryesore politike të agjencive ndërkombëtare me të cilat gazetarët dhe mediat duhet të njoftohen:

PROCESI I RABATIT	Dialogu Evropiano-Afrikan për migracion dhe zhvillim https://www.rabat-process.org/en/about/rabat-process
PROCESI I KARTUMIT	Platforma për bashkëpunimin politik ndërmjet vendeve përgjatë trajektorës së migracionit midis Britit të Afrikës dhe Evropës https://www.khartoumprocess.net/
PROCESI I BUDAPESTIT	Proces këshillëdhënës midis 50 vendeve për migracionin https://www.icmpd.org/our-work/migration-dialogues/budapest-process/
PROCESI I PRAGËS	Dialog për migracionin midis vendeve të Bashkimit Evropian, Zonës së Shengenit, Partneritetit Lindor, Ballkanit Perëndimor, Azisë Qendrore, Ruisë dhe Turqisë https://www.pragueprocess.eu/en/
DIALOG PËR TRANZICIONIN MESDHETAR TË MIGRACIONIT	Dialog këshillëdhënës midis funksionarëve të cilët luftojnë kundër migracionit dhe problemeve të ngjashme https://www.icmpd.org/our-work/migration-dialogues/mtm-dialogue/
MARRËVESHJA GLOBALE PËR MIGRACION	Iniciativa e Kombeve të Bashkuara për qasje holistike ndaj migracionit https://refugeesmigrants.un.org/migration-compact
PLANI I VEPRIMIT GLOBAL PËR LUFTË KUNDËR TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE	Strategjia e Kombeve të Bashkuara për Luftë Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore https://www.un.org/pga/72/event-latest/global-plan-of-action-to-combat-trafficking-in-persons/
ORGANIZATA NDËRKOMBËTARE E PUNËS	Organizata kryesore e KB për punë me detyrim dhe punën e fëmijëve https://www.ilo.org/global/lang--en/index.htm

<p>GRUPI KOORDINATIV NDËRSEKTORIAL KUNDËR TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE</p>	<p>Bashkëpunim i ndërsjellë i agjencive të KB në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore http://icat.network/</p>
<p>ALEANCA KUNDËR TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE</p>	<p>Forumi i gjerë ndërkombëtar i vendosur nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë https://www.osce.org/secretariat/107221</p>
<p>ALEANCA 8.7</p>	<p>Aleanca Ndërkombëtare për Luftë Kundër Punës së Fëmijëve https://www.alliance87.org/</p>
<p>REDAKSIA PËR MIGRACION</p>	<p>E themeluar për gazetarët, nga ana e Organizatë Ndërkombëtare të Migracionit https://www.iom.int/press-room/newsdesk</p>
<p>STORJE PËR MIGRACIONIN</p>	<p>Brifingje nga Komisionari i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë https://www.unhcr.org/uk/news-and-stories.html</p>
<p>PROJEKTE PËR LUFTË KUNDËR TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE TË ICMPD</p>	<p>Rezyme të veprimeve që i ndërmerr Qendra Ndërkombëtare për Zhvillimin e Politikave të Migracionit, e cila realizon hulumtime dhe përsosje gjithëpërfshirëse, e mbështet zhvillimin e politikave kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe kontribuon në bashkëpunimin ndërkombëtar në këtë fushë, veçanërisht në sferën e trafikimit të qenieve njerëzore https://www.icmpd.org/our-work/capacity-building/programmes/anti-trafficking-programme/ongoing-projects/?L=0</p>

Linqe dhe shembuj të dobishëm për raportim të mirë

<https://www.freetheslaves.net/about-slavery/faqs-glossary/>

Njëra nga shumë organizatat joqeveritare ndërkombëtare që bashkëpunon shkëlqyeshëm me gazetarët.

<https://gijn.org/human-trafficking-resources-best-practices-in-reporting/>

Resurs i shkëlqyer me shembuj për praktika dhe këshilla të mira për gazetarët dhe organizatat e medias nga Rrjeti Global i Gazetarëve Investigativ.

Patrik Kingzli, nga “The Guardian” dhe njëri nga gazetarët kryesorë të Britanisë, flet për sfidat e raportimit mbi krizën e refugjatëve.

Lexoni artikullin e plotë:

<https://cutt.ly/Sg2NVkx>

Hetimi i “The Guardian” zbulon se si veprimtaria e peshkimit në Libi përjetoi invazion të kontrabandistëve me njerëz, të cilët për një kohë të shkurtër blenë anije për të transportuar migrantë dhe refugjatë përmes Mesdheut.

Lexoni artikullin e plotë:

<https://cutt.ly/xg2N0r5>



Disa nga udhëzimet ekzistuese për raportimin e mediave të cilat janë të aksesshme në internet

Trafikimi i qenieve njerëzore dhe mediat. Manual për gazetarë. Manuali është publikuar në vitin 2010 me mbështetjen e Organizatës për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë (OSBE), ndërsa autorët janë specialistë për mbrojtjen e trafikimit të qenieve njerëzore nga organizata joqeveritare Porta e Hapur – “La Strada” dhe gazetari i cili i trajton këto tema. Manuali ka për qëllim t’i fuqizoj kapacitetet e mediave për raportim profesional për trafikimin e qenieve njerëzore.

Lexo më shumë: <https://cutt.ly/sg2N7fa>

Pasqyrë e prezantimit mediatic të trafikimit të qenieve njerëzore. Ky publikim ofron pasqyrë për mënyrën me të cilën trafikimi i qenieve njerëzore pasqyrohet në mediat informative, - ndërkohë që përfshinë edhe studime të rastit nga Mbretëria e Bashkuar, Qipro dhe Polonia. Në raport janë përmbledhur 212 artikuj nga dhjetë gazeta të botuara në periudhën nga viti 2010 deri në vitin 2014.

Lexo më shumë: <https://lastradainternational.org/doc-center/3090/review-of-the-media-framing-of-human-trafficking>

Rekomandime Etike dhe të Sigurisë të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh) për intervistimin e grave të trafikuar nga viti 2003. Krahas materialit në sfond si justifikim për këto rekomandime, dokumenti i OBSh përmban edhe “dhjetë parime udhëzuese për sjelljen etike dhe të sigurisë gjatë intervistimit të grave të trafikuar”.

Lexo më shumë: https://www.who.int/mip/2003/other_documents/en/Ethical_Safety-GWH.pdf

Parime dhe udhëzime për raportimin etik të fëmijëve të UNICEF. Qëllimi i këtij dokumenti është “t’u ndihmojë mediave që të raportojnë për fëmijët në mënyrë sensitive dhe në mënyrë e cila është adekuate për moshën. Këto udhëzime kanë për qëllim t’i mbështesin qëllimet më të mira të raportuesve etik. Të jenë në shërbim të interesit publik pa u komprometuar të drejtat e fëmijëve”.

Lexo më shumë: <https://www.unicef.org/media/reporting-guidelines>

Migracioni dhe mediat. Manual për gazetarë. Qëllimi i këtij Manuali i cili u hartua me ndihmën e BE dhe ICMPD konsiston me atë që gazetarëve t’u sigurohen njohuri themelore për çështjet komplekse të migracionit, refugjatëve dhe trafikimit të qenieve njerëzore, si dhe për ndikimin e tyre mbi rrjedhat globale.

Lexo më shumë: <https://cutt.ly/Yg2Muji>

Zyra e Programit e Këshillit të Evropës në Shkup,

Qendra Afariste Soravia

Filip Vtori Makedonski 3,

1000 Shkup

tel.: +38923100 330

Ueb-sajt: <http://horizontal-facility-eu.coe.int>

E-mejl: horizontal.facility@coe.int

facebook: [@jp.horizontal.facility](https://www.facebook.com/jp.horizontal.facility)

Twitter: [@CoE_EU_HF](https://twitter.com/CoE_EU_HF)

Ky publikim u hartua mbështetjen financiare të një programi të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Përmbytja e këtij publikimi në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pikëpamjet zyrtare të **Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës**.

Këshilli i Evropës është organizatë prijëse për të drejtat e njeriut në kontinent. Ai përbëhet nga 47 shtete anëtare, përfshirë këtu të gjitha shtetet-anëtare të Bashkimit Evropian. Të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës janë nënshkruese të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila është një marrëveshje ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, demokracisë dhe sundimit të ligjit. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut e monitoron zbatimin e kësaj Konvente nga ana e vendeve anëtare.

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian vendosën t'i lidhin njohuritë, resurset dhe fatet e tyre. Ato bashkërisht e ndërtuan zonën e stabilitetit, demokracisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm, njëherësh duke e ruajtur diversitetin kulturor, tolerancën dhe liritë individuale. Bashkimi Evropian angazhohet për ndarjen e arritjeve dhe vlerave të veta me shtetet dhe popujt edhe jashtë kufijve të vet.

www.coe.int

www.europa.eu

Financuar
nga Bashkimi Evropian
dhe Këshilli i Evropës



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet
nga Këshilli i Evropës

